



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1680 / Prot.

Vlorë më, 22.09. 2023

VENDIM
Nr. 31, datë 22.09.2023
PËR

PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUAR PËR STAFIN
AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma e të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*", si dhe referuar propozimit të Administratorit nr.1455/16 prot, datë 14.08.2023 dhe Vendimit të Senatit akademik nr 44, prot , datë 16.08.2023, në mbledhjen e datës 22.09.2023 Bordi i Administrimit.

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2022-2023 deri në 200 orë në auditor.
2. Referuar nenit 2, pika 1 të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*" të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023 nga 200-300 orë për orët suplementare në auditor, vetëm për rastet ku eksizton propozimi i njësisë bazë dhe miratimi i drejtuesit të njësisë kryesore, i cili konsideron rastin si specifik.
3. Të miratojë pagesën për orët jashtë auditorit referuar vendimit nr. 44 të SA, datë 16.08.2023 si dhe shkresave të Zv/Rektorit Akademik dhe Administratorit përveç pagesës së mbingarkesës së orëve të udhëheqjes së temave të diplomës të pajustificuara me dokumentacion.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Sotir NIKOLLA